



**Sindikata e Punonjesve të Poste-Telekomit Shqiptar, ka kenaqesine të njoftojë të gjithë punonjësit e kompanisë Makhes se mbas negociatave me punedhësin është arritur firmosja e kontratës kolektive.**

Gjatë këtyre negociatave Sindikata është fokusuar për zgjidhjen e problematikave dhe kërkesave, të cilat janë identifikuar gjatë takimeve me punonjësit e kompanisë. Mbas analizimit të tyre është mbajtur në fokus sidomos pjesa e të punuarit me orë të zgjatura, mos pagesa e orëve jashtë orarit, shqetësimet për mos informimin mbi pagën dhe orët shtesë të paguara, siguria dhe shëndeti në vendin e punës, indeksimi i pagave, mungesa e bazës materiale etj.

Të gjithë punonjësit ata aktual, si dhe ata që kanë filluar punë rishtazi në Makhes duhet të informohen mbi të drejtat kryesore që lindin nga kjo Kontrata Kolektive. I gjeni të përmbledhura si më poshtë:

1. Punedhësi është i detyruar të **respektojë dhe mbrojë personalitetin e Punemarresit**, si dhe të marrë të gjitha masat e nevojshme për të garantuar sigurinë dhe mbrojtjen e **shëndetit mendor dhe fizik të punonjesve**.
2. Punedhësi për të parandaluar **aksidentet dhe semundjet profesionale** duhet të përcaktojë qartë **rregullat e sigurimit teknik dhe të kualifikojë punemarresit** për zbatimin e këtyre rregullave, sipas dispozitave ligjore në fuqi.
3. Punedhësi detyrohet të sigurojë me shpenzimet e veta: **kushtet** e nevojshme të ambienteve të punës, **mjetet e punës, uniformat** e punonjesve të rrjeteve, **trajnimin** e punonjesve brenda vitit sipas nevojës dhe pozicioneve të punës që ka shoqëria.
4. Punedhësi bie dakort një herë në vit të bëjë indeksimin e inflacionit në masën jo më pak se norma e inflacionit publik.
5. Në përfundim të çdo viti kalendarik, gjatë afatit të zbatimit të kësaj Kontrate, si dhe bazuar në performancën dhe fuqinë paguese të kompanisë, Punedhësi bie dakort të japë një shpërblim të barabartë me jo më pak se 5,000 (pese mijë) Leke Neto.
6. Punedhësi detyrohet të zbatojë parimin e barazisë në shpërblim, për punë të njëjta ose punë me vlerë të barabartë, pa diskriminuar asnjë.
7. Punedhësi, nuk duhet të mbledhë informacione lidhur me punemarresit, përveç rasteve, kur këto informacione lidhen me aftësitë profesionale të punemarresve ose janë të nevojshme për zbatimin e kontratës. Punedhësi është i detyruar të marrë masa sigurie për mbrojtjen e të dhënave personale të punemarresve në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.
8. Për gratë shtatzena pushimi do të jetë çdo 3 orë, jo më pak se 30 minuta. Ndalohet kryerja e orëve shtesë të punës nga gratë shtatzena, si dhe pas lindjes së fëmijes derisa fëmija të mbushë moshën 1 vjeç. Gjithashtu ndalohet kryerja e orëve shtesë për personat me aftësi të kufizuara.

9. Punedhenesi i paguan rregullisht pagen Punemarresit nje here ne muaj, me perjashtim te atyre rasteve kur palet kane parashikuar ndryshe ne nje marreveshje me shkrim. **Punëshënësi njofton në mënyrë periodike punëmarësit në lidhje me pagesën e dhënë sipas punës së kryer nga secili punëmarës. Njoftimi për këtë qëllim do të kryhet në adresat e postës elektronike, ose nëpërmjet dërgimit të sms, sipas përcaktimeve që do të bëhen në kontratat individuale të punës.**
10. Oret shtese qe kerkohen te kryhen per nevoja te Shoqerise nuk duhet te kalojne **200 ore ne vit.**
11. Nuk mund te kerkohet kryerja e oreve shtese javore kur punemarresi ka kryer **48 ore pune** ne jave.
12. Punedhenesi per oret shtese te punes qe nuk jane kompensuar me pushim duhet t'i paguaje punemarresit pagen normale dhe nje shtese jo me pak se 25% te saj.
13. Oret shtese te punes te kryera gjate pushimit javor ose ne ditet e festave zyrtare kompensohen me pushim ose page te pakten 50% me te madhe se oret shtese te bera nga paga normale.
14. Punonjesit do te kene te drejten e jo me pak se 36 ore pushimi javor, prej te cilave 24 ore pa nderprerje.
15. Puna e kryer ne ditet e pushimit javor kompensohet me nje shtese page, jo me pak se 25%, ose me nje pushim te pagueshem, te barabarte me kohezgjatjen e punes se kryer plus nje pushim shtese, jo me pak se 25% te kohezgjatjes se kesaj pune.
16. Puna e kryer ne ditet e festave zyrtare, kur ato bien dite pune, kompensohet me nje shtese mbi page, jo me pak se 25% dhe me nje pushim te pagueshem, te barabarte me kohezgjatjen e punes se kryer ne ditet e festave zyrtare.
17. Pushimi merret nje jave para ose pas kryerjes se punes.
18. Kohezgjatja e Lejes Vjetore eshte jo me pak se 4 (kater) jave kalendarike gjate vitit te punes e ne vazhdim. Kur punemarresi nuk ka kryer nje vit pune te plote, kohezgjatja e pushimeve vjetore te paguara percaktohet ne raport me kohezgjatjen e marredhenieve te punes. Periudha e paaftesise se perkohshme ne pune konsiderohet si kohe pune.
19. Per punonjesit qe fillojne pune ne shoqerine **MAKHES Albania** e drejta e pushimeve vjetore i fillon pasi punonjesi te kete kryer periudhen tre mujore te proves. Kur punëmarrësi nuk ka kryer një vit pune të plotë, kohëzgjatja e pushimeve vjetore të paguara përcaktohet në raport me kohëzgjatjen e marrëdhënieve të punës.
20. Punedhenesi duke marre parasysh deshiren e Punemarresit percakton daten e fillimit te pushimeve vjetore te paguara duke e njoftuar te pakten 15 dite perpara. Pushimi vjetor shtyhet kur punemarresi, gjate periudhes se ketij pushimi ka nje raport mjekesor.
21. Pushimet vjetore duhet te jepen gjate vitit te punes ose deri ne fund te tre muajve te pare te vitit pasardhes. E drejta e pushimeve parashkruhet brenda tre vjeteve nga dita ne te cilen punemarresit i lind kjo e drejte.
22. Kur marredhenia e punes ka perfunduar dhe punemarresi nuk i ka kryer pushimet qe i takojne. Ne kete rast, ai ka te drejte per nje shperblim te barabarte me pagen e ketyre pushimeve.

### Te drejtat dhe Lirite Sindikale

- Lejohet pjesemarrja e lire dhe vullnetare e punonjesve ne sindikate dhe askush nuk mund te diskriminohet per kete arsye.
- Punedhenesi duhet te informoje perfaqesuesit e punemarresve dhe te konsultohet me ta rregullisht, se paku, nje here ne vit, per aktivitetet aktuale dhe te ardhshme te ndermarrjes.

- Punedhenesi ne perputhje me dispozitat e Kodit te Punes , ka te drejte te transferoj pjese te kompanise apo kompanine,duke siguruar ne cdo rast mbrojtjen e te drejtave dhe detyrimeve te punemarresve, qe lindin nga kjo kontrate tek punedhenesi i ri.Ne kete rast , Punedhenesi do te konslutohet me perfaqesuesin e Punemarresve,sipas percaktimeve ligjore.
- Punedhenesi ne rastet e pushimit kolektiv, respekton percaktimet e nenit 148 te Kodit te Punes se Republikes se Shqiperise,ne lidhje me proceduren qe duhet te ndiqet dhe perfitimet e punemarresve te perfshire ne te.

<b>Pushime dhe Perfitime te tjera</b>	
Ne rast martese te Punemarresit	<i>5 dite pushim te paguar</i>
Ne rast te vdekjes se bashkeshortit/es/bashkejetuesit/es te saj/tij; paraardhesve ose pasardhesve te drejtperdrejte te tij dhe te bashkeshortit/es//bashkejetuesit/es te saj/tij si dhe personave qe bashketojne me te sipas certifikates familjare.	<i>5 dite pushim te paguar</i>
Ne rast semundjeje te rende te anetareve te familjes, bashkejetuesit, te paraardhesve ose te pasardhesve te tij te drejtperdrejte,apo dhe te bashkeshortit / es / bashkejetuesit / es te saj / tij si dhe personave qe bashketojne me te sipas certifikates familjare, te vertetuar me raport mjekesor, punemarresi perfiton	<i>30 dite pushim te papaguar.</i>
Ne rastin e lindjes se femijes per baballaret	<i>3 dite pushim te paguar</i>
Per pergatitjen dhe mbrojtjen e titujve pasuniversitar si dhe trainimeve te ndryshme ne lidhje me profesionin qe ushtron, me miratimin paraprak te Punedhenesit, Punemarresi perfiton	<i>10 dite pushim te paguar ne vit</i>
Ne rast perkujdesje per antaret e familjes qe bashkejetojne me te, (bashkeshorti/bashkeshortja, paraardhesit dhe pasardhesit ne ngarkim) si dhe raste te tjera te pranueshme nga Punedhenesi.	<i>30 dite ne vit</i>
Leje Prinderore (sipas Nenin 132/1 te Kodit te Punes se Republikes se Shqiperise)	<i>jo më pak se 4 muaj, derisa fëmija që ka në ngarkim të arrijë moshën 6 vjeç</i>
Ne rast vdekje te vete punemarresit	<i>2 paga mujore</i>
Ne rast vdekje te punemarresit ne pune.	<i>5 paga mujore</i>
Me rastin e daljes ne pension.	<i>1 page mujore</i>
<i>Punedhenesi mund te shperbleje punonjesit e tij ,duke marre parasysh vleresimin e performances dhe gjendjen financiare te kompanise ne mbylljen e bilancit te vitit ushtrimor.Gjithashtu Punedhenesi ne varesi te gjendjes financiare te Kompanise , mund te jape shperblime ose te rrite pagat per punonjesit e tij.</i>	

Firmosja e kontrates kolektive nuk eshte mbarimi i njeres prej detyrave kryesore te sindikates,por eshte fillimi i punes per monitorimin e respektimit te te drejtave qe rrjedhin nga kjo kontrate. Pavaresisht se me ane te kesaj kontrate eshte bere nje arritje per te vendosur ne kontrate nje pike qe detyron punedhenesin t'ju dergoj Informacion mbi Pagen dhe Oret Jashte Orarit cdo muaj punonjesve, ne mbetemi te angazhuar per te monitoruar implementimin e kesaj pike.

Sindikata po vazhdon punen dhe eshte ne negociata me Albtelecom per dy ceshtje te rendesishme sic eshte paketa ADSL+IPTV dhe dita e Diel Pushim. Ashtu si Sindikata ndermjetesoi marrredhenien midis **Makhes & Albtelecom** per te shtyre **biletën nga 24 ore ne 48 ore**,ne menyre qe te gjithë punonjesit e rrjeteve te benin pushim gjate festave zyrtare, po punon per zgjidhjen edhe te ketyre dy kerkesave.

Puna po vazhdon edhe per monitorimin e aplikimit te indeksimit te pagave, sigurimin e punonjesve dhe realizimin e check-up mjekesore per te gjithë punonjesit.

